



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2020

Lënda: Kthim përgjigje

E Nderuar,

Në përgjigje të kërkesës suaj për informim ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

1- “Persona më aftësi të kufizuara” sipas neni 3, pika 4, shkronja c, kemi 3 persona me aftësi të kufizuar (invalid pune, të vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse-6 orë) , ndërsa persona më aftësi të kufizuara në lëvizje nuk kemi.

Bashkia Shkodër ka në hyrje të saj të ndërtuar një rampë që bën të mundur aksesimin e personave më aftësi të kufizuar në lëvizje.

2- A e disponon Bashkia Shkodër infrastrukturën e nevojshme për lehtësimin e kushteve të punës për personat me aftësi të kufizuar, psh ashensor nëse e ka punën në kat të dytë apo rampa?

Bashkia Shkodër konsideron të rëndësishme krijimin e përshtatshmërisë dhe lehtësirave në komunikim, gjithëpërfshirjen dhe aksesin në shërbime për të gjithë personat me aftësi të kufizuara duke synuar shërbime dhe ambiente publike të mundshme për të gjithë.

Bashkia Shkodër disponon në hyrjen e saj rampë, konform standarteve ligjore, përshtatshmërisë dhe krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë.

Çdo qendër komunitare “Për Familjen” e krijuar dhe e vënë në zbatim nga Bashkia e Shkodrës ka përshtatshmërinë për akses për personat me aftësi të kufizuara: rampa apo ashensor. Me dëshirën për të rritur integrimin e PAK në jetën dhe aktivitetet publike, institucionet publike, si shkollat, biblioteka, qendrat sociale, trotualet, etj.të gjitha projektet e reja infrastrukturore (qendra komunitare, qendra multifunktionale, etj.) dhe rikonstruksionet e godinave ekzistuese të Bashkisë së Shkodrës (biblioteka “Marin Barleti”, shkollat, etj) janë krijuar me përshtatshmërinë për personat me aftësi ndryshe.

Çdo ndërtim i ri dhe çdo rikonstruksion infrastrukturor i realizuar nga Bashkia e Shkodrës ka përshtatshmërinë për akses për PAK (rampa, ashensor, tualete, etj.)

Qendra Rinore Atelie, Qendra Komunitare Multifunkionale “Për Familjen”, Qendra Komunitare “Për Familjen” Rrethina dhe ambientet e shoqatës së Para&Tetraplegjikëve kanë tualete për PAK.

Çdo ndërhyrje është realizuar konform standarteve ligjore, përshtatshmërisë dhe krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

K R Y E T A R

Voltana ADEMI